REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 921/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.921/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina – Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Botek"SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontrtës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Infosoft Systems SH.P.K, Future Bits"SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim lidhur me digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve" me nr. të prokurimit: 208 udhëheqësi-20-3925-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Arsimit", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Botek"SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim lidhur me digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve" me nr. të prokurimit: 208 udhëheqësi-20-3925-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Arsimit".

II. <u>ANULOHET,</u> njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim lidhur me digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve" me nr. të prokurimit: 208 udhëheqësi-20-3925-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Arsimit", dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Botek"SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Botek"SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.11.2020 me nr. 921/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim lidhur me digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve nëpër shkolla si dhe furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve" me nr. të prokurimit: 208 udhëheqësi-20-3925-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Ministria e Arsimit", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 56 parag.3, 59 parag. 4, si dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përshkrim i përgjithshëm

Gjatë këtij aktiviteti të prokurimit publik nga ana e OE të interesuar për të marrë pjesë janë bërë në total 5 kërkesa për rishqyrtim, janë dy njoftime për korrigjim te gabimeve nga ana e AK-së, dy raporte te vlerësimit dhe dy njoftime për vendimet e AK-së. Të gjitha janë bërë brenda afateve kohore te parapara në DT, NJK dhe legjislacionin e prokurimit si dhe përgjigjet nga ana e AK-së janë dhenë brenda afateve

kohore të parapara me LPP. Aktiviteti i prokurimit është i ndarë në dy grupe (Lot) nga ana e AK-së. Grupi 1. Furnizim lidhur me Digjitalizimin e materialeve moderne, modernizimi i shërbimeve neper shkolla dhe Grupi 2. Furnizimi me pajisje të shërbimeve online për shkollat e të verbërve. OE ankues ka ofertuar vetëm për grupin 1 (Lot 1), pretendimet e tij ankimore i kam përmbledhur në total tri të tilla, dy prej tyre kanë të bëjnë me plotësim/mos plotësim të specifikave teknike për produktin e ofruar nga OE ankues dhe arsyetimet e tij për plotësim të kërkesave minimale teknike si dhe pretendimi i tretë ka të bëjë me çmimet e ofruara nga OE ankues dhe GOE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë dhe krahasimi i tyre me çmimet me pakicë të produkteve të njëjta/ngjashme në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Pasi që OE ankues në ketë ankesë vetëm i ka cekur pretendimet ankimore nga ankesa me numër 673/20, nuk i ka shënuar ato, gjithashtu i ka cituar konstatimet e ekspertizës paraprake, për te nxjerrë rekomandimet e mia, i kam analizuar ankesën 673/20, ekspertizën e ekspertit dhe vendimin e P.SH, gjithashtu përgjigjen e AK-së në kërkesën për rishqyrtim dhe raportin e rivlerësimit, të gjitha këto informata i kam krahasuar dhe analizuar përsëri, të gjeturat dhe rekomandimet e mia i kam paraqitur në pjesën në vijim të kësaj ekspertize.

Pretendimi nr. 1

Ne edhe njëherë përtej provave teknike të dhëna ne procedurën e kaluar të Ankesës e të cilat vlejnë edhe për këtë procedurë, po i Ri-konfirmojmë vetëm deklarimin e Ekspertit kur edhe e qartëson ketë pretendim të AK dhe deklaron se përformancen e procesorit nuk e përcakton vetëm numri i frekuencës (GHz) dhe NUK është element absolut apo indikatorë mbi bazën e të cilit mund të krahasohen dhe vlerësohen dy procesorë. (Këtu duhet ta plotësojmë dhe ta Ri-konfirmojmë gjithashtu se CPU-ja e pajisjes së ofertuar nga ne e ka numri i Cora-ve të njëjtë me atë që kërkohet ne Aneksin 1 të DT).

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të NJK, Dosjes së tenderit, specifikacionit teknik te bashkangjitur si fakt 1 ne ketë ekspertizë dhe broshurës të OE ankues ku është i paraqitur produkti me të cilin ky OE ka aplikuar për grupin 1, konkretisht Tablet – Brand name. OE ankues ka ofertuar me produktin "muPAD L10 tabletë" i prodhuesit Koreano Jugor "FORYOU DIGITAL CO" LTD. http://ëëë.foryoudigital.com/22/?idx=254 , që është firmë korean jugore me fabrikë për prodhim në Kinë. Konfirmoj se njëjtë sikur në ekspertizën paraprake dhe në njoftimin mbi vendimin e AK-së pas rivlerësimit, që produkti i ofertuar nga OE ankues përmban procesor me 8 bërthama (core) njëjtë si është kërkesa nga AK, është model "Spreadtrum SC9863A Octa Core (8-bërthamësh)" pra janë 8 procesorë ne një qark të vetëm", i familjes *ARM* Cortex *A-55* i cili i ka të ndara 4 bërthama me frekuencë 1.6GHz dhe 4 bërthama me frekuencë 1.2GHz, që sa i përket frekuencës së procesorit nuk e plotëson kërkesën obligative në DT ku kërkohen minimum 4 bërthama 2.3GHz and 4 bërthama 1.7GHz. Sa i përket

pretendimit ankimor është e vërtetë që në përformancen e përgjithshme të procesorit sado që është faktor me rendësi nuk është vendimtar vlera e frekuencës e shprehur në GHz apo MHz, përpos kësaj faktor me rendësi tek performansa e procesorit janë edhe ndër të tjera: Bus-i i përparmë, cashe memoria, shpejtësia e clockut që tregon numrin e operacioneve te cilat mund ti ekzekutoj procesori brenda sekondës-ciklit (e sqaruar në mënyrë te detajuar dhe shkollore nga ana e AK-së në përgjigjen e tyre në kërkesën për rishqyrtim të datës 05.11.2020), sa me e lartë të jetë shpejtësia e clockut aq me shumë veprime mund ti ekzekutoj procesori brenda ciklit, kjo në fakt është edhe rasti me produktin e OE ankues, por është e rëndësishme të kuptohet se shpejtësia e clock-ut e një procesori nuk është faktori i vetëm që përcakton performancën e tij. Për shkak të ndryshimeve në arkitekturën e çipave (familjet e procesorëve) dhe zhvillimit të hovshëm teknologjik të këtyre komponentëve, një procesor mund të jetë në gjendje të kryejë më shumë veprime sesa një tjetër për një cikël, madje edhe nëse procesori i parë ka një shpejtësi më të vogël (frekuencë) të clock-ut sesa i dyti, ky është rasti i produktit të ofruar nga OE ankues, produkt i cili ka procesor te familjes me të re se sa ai i produktit të OE te propozuar për tu shpërblyer me kontratë, është e vërtetë se është më pak i shitur se procesori ARM Cortex A-53, por kjo është e kuptueshme sepse është zhvilluar dhe paraqitur në treg disa vite me vonë. https://ëëë.techëalla.com/articles/hoë-is-the-cpu-speed-measured. Pra procesori i produktit të OE ankues është pas ardhës me i avancuar i procesorit të produktit me të cilin kanë ofertuar GOE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë. Busi i përparmë (front side bus) dhe cashe kanë gjithashtu rol shumë te rëndësishëm në përformansën e procesorit. Procesori dhe front side bus punojnë së bashku, kështu që ata do të jepnin përformansën ideale nëse do të funksiononin me të njëjtën shpejtësi në mënyrë që njëri të mos mund të ngadalësojë tjetrin. Cache-memoria gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në përformansën e procesorit, sa më e madhe të jetë memoria, aq më e mirë është performansa e procesorit. Me analizimin e procesorit të produktit të ofruar nga OE ankues vërehet që këto përformansa janë mjaft të mira edhe pse shpejtësia e bërthamave është më e vogël se sa ajo e kërkuar në specifikacionin minimal teknik nga ana e AK-së dhe përpos kësaj shpejtësie në përgjithësi ky produkt i plotëson kërkesat minimale.

Mendoj që produkti i ofertuar nga OE ankues sa i përket frekuencës së procesorit nuk është në përputhje me kërkesat minimale teknike të cekura në DT, por sa i përket përformansës së përgjithshme dhe komponentëve tjera është mjaft i mirë dhe nuk kam dyshim që nuk do ta kryente pa problem qëllimin dhe detyrat për të cilat do të ngarkohet nga përdoruesit e fundit, e këtu ka rendësi edhe çmimi kogja më i ulët i këtij produkti në krahasim me produktin e ofertuar nga GOE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë, por prapë mendoj që vendimi final dhe përgjegjësia për përzgjedhjen finale i takon vetëm Autoritetit Kontraktues duke aplikuar në mënyrë të saktë LPP-në. Duke i marrë parasysh këto që u thanë në lidhje me ketë pretendim ankimor mendoj qe ky pretendim të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi nr. 2

Tutje eksperti i kësaj lënde në ekspertizën e tij sqaron, Citat: "Nëse bëjmë krahasimin e procesorit të ofertuar nga OE ankues (UNISOC SC9863A) dhe procesorit të pajisjes së ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë (MediaTek Helio P22T (8xARM Cortex-A53, up to 2.3GHz)), procesori i ofertuar nga OE ankues është Cortex-A55 (ARM v8.2-A) ndërsa procesori i OE të rekomanduar për kontratë është Cortex-A53 (ARM v8.0-A).

Sipas informatave të ARM

kups://community.arnt.cont/developer/ip-products/processors/b/processors-ip-bloz/posulann-cortex-a55-efficientperformance-from-edge-to-clondj, procesori Cortex-A55 është gjeneratë pasardhëse e procesorit ARM Cortex-A53, i krijuar për të përmirësuar performancën dhe efikasitetin e energjisë. Gjithmonë sipas informatave të prodhuesit ARM, arkitektura Cortex A55 është për 15% më efikas në energji dhe 18% rritje të përformancës në krahasim me A53".

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të NJK, dosjes së tenderit, specifikacionit teknik, ofertave, broshurave, hulumtimit dhe krahasimit në internet, sqaron se duke marrë për bazë arkitekturën e procesorëve te këtyre produkteve, sipas sqarimit të dhënë nga vetë prodhuesi arkitektura e Cortex A55 ka avancime në performancë dhe efikasitetin në raport me arkitekturën e Cortex A53, familjes të së cilit i takon procesori i cili ndodhet në produktin e ofertuar nga OE i propozuar për kontratë, shih vegzat ne vijim te nxjerra nga ëeb faqja e prodhuesit: https://community.arm.com/developer/ip-products/processors/b/processors-ip blog/posts/arm-cortex-a55-efficient-performance-from-edge-to-cloud dhe https:// developer. arm.com/ip-products/processors/cortex-a/cortex-a55, rrjedhimisht në kuptimin e përmbushjes së qëllimeve të aktivitetit të prokurimit, mendoj qe procesori i produktit të ofertuar nga OE ankues përmbush funksionet dhe arrin performancën e kërkuar. Andaj sipas sqarimeve të mësipërme propozoj qe ky pretendim ankimor të aprovohet si i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi nr. 3

AK si kriter të saj për dhënien e kontratës është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët ashtu siç e parasheh neni 52 të LPP por në praktik është e kundërta me veprimet e saja AK (MASHT) e eliminon ofertën e përgjegjshme me çmim më të ulët (823.500 € të OE BOTEK sh.p.k. apo 165€/copë) dhe propozon për kontratë një ofertë tej mase me të lartë 1.139.400 €, apo 227€/copë, rrjedhimisht 38% me të lartë). Për Informacionin tuaj; Çmimet standarde (me pakicë) gjithandej nëpër Evropë janë më të ulëta, sikurse: https://gjirafa50. com/celulare- tablete-dhe-pajisje-smart/tablete/me-google-android/tablet-

lenovo-m10-plus,-4gb-64gb,-hiri/#rel=2 https://ëëë.idealo. de/preisvergleich/ OffersOfProduct/ 7041006_ -tab-m10-plus-za5t0302-lenovo.html (Gjermani – DE, çmimet mesatare të këtij Tableti Inkl. VAT dhe Transporti në shtëpi kudo ne DE). https://ëëë.coolshop.co.uk/product/lenovo -m10-fhd-plus-2nd-gen-tb-x606ftablet/234S9V/?utm_medium=affiliate&utm_source=salestring&utm_campaign=The+Affiliate+Gateëay%E2%80%8B (Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakice për cope incl. VAT dhe Transporti deri ne shtëpi kudo ne UK).

https://ëëë.lenovo.com/gb/en/tablets/android-tablets/lenovo-tab-series/Lenovo-TB-X606Smart-Tab/p/ZZITZTMST0X (Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakice për cope incl. VAT dhe Transporti ne shtëpi ne UK).

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të Dosjes së tenderit, dhe ofertave të dorëzuara nga ana e OE ankues dhe atyre të propozuar për shpërblim me kontratë e konfirmoj që Oferta e OE ankues në total dhe për copë është me e lirë se ajo e GOE te propozuar (te cilët kanë ofertuar me produktin Lenovo Tab M10 FHD plus), por këtu kemi te bëjmë me dy produkte të ndryshme te prodhuesve të ndryshëm të përberë nga komponentë të ndryshme por me përformanca të përafërta, gjithashtu i konfirmoj edhe çmimet në linçet e paraqitura nga OE ankues në ankesë dhe se janë me të lira (çmimi pakicë fillon nga 174.37 me TVSH të përfshirë, 188.00 dhe 205.00 euro) se çmimi që është ofruar nga OE i propozuar, por prapë se prapë për të bëre krahasim të mirëfilltë duhet krahasimi të behët në kushte të njëjta siç janë sasia, garancioni 2 vjeçar, liferimi e që këto kushte nuk janë në ketë rast. Tek çmimi që është me i lartë mendoj që ka ndikuar jo vetëm se brendi "Lenovo" është brend me i njohur dhe më i përhapur se sa brendi i produktit te ofertuar nga OE ankues, por edhe kërkesa obligative e cekur ne DT dhe NJK nga ana e AK-së ku kërkohet garancion 2 vite si dhe liferimi të bëhet brenda 45 ditëve pas porosisë.

Duhet të cekët qe kriter për dhënie të kontratës është "tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët", kurse oferta e OE të propozuar është më e lartë nga të gjitha ofertat tjera por prapë se prapë është brenda buxhetit të paraparë nga AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit publik dhe nëse do të pranoheshin specifikat teknike të produktit të diskutuara në pretendimet 1 dhe 2 atëherë do të duhej të propozohej për kontratë oferta e OE ankues. Propozoj që ky pretendim ankimor të aprovohet si pjesërisht i bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së. Si përmbyllje nga të gjitha faktet, te gjeturat, analizat dhe krahasimet, për mendimin tim AK nuk ka vepruar tërësisht në përputhje me vendimin e ankesës 673/20 të datës 22.10.2020 dhe rekomandimet e dala nga ky vendim nuk janë aplikuar plotësisht nga komisioni rivlerësues i AK-së. Mendoj që ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së dhe Aktiviteti i Prokurimit të kthehet në rivlerësim. Për fund mendoj që, edhe pse oferta e GOE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë është teknikisht dhe administrativisht e

përgjegjshme dhe është brenda buxhetit të paraparë nga ana e AK-së për ketë aktivitet te prokurimit publik, por për mendimin tim edhe oferta e OE ankues i plotëson kërkesat minimale teknike, është administrativisht e përgjegjshme dhe me çmim me të ulët ashtu që do të kursehej buxheti i shtetit për dallimin në çmim e ofruar nëse do të shpërblehej me kontratë OE ankues dhe AK do të vepronte në përputhje të plotë me nenet 1 dhe 6 të LPP-së, të cilat i obligojnë AK-të që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike te mundshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në faktet, hulumtimet, krahasimet, sqarimet dhe të gjeturat tjera të cekura në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në **rivlerësim** dhe rivlerësimi të bëhet në përputhje të plotë me LPP-në dhe legjislacionin sekondar.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik: "Botek"SH.P.K - Prishtinë, me datë: 30.11.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Botek" Sh.k.p.k.-Prishtinë, se edhe njëherë përtej provave teknike të dhëna ne procedurën e kaluar të ankesës e të cilat vlejnë edhe për këtë procedurë, po i Ri-konfirmojmë vetëm deklarimin e ekspertit kur edhe e qartëson ketë pretendim të AK dhe deklaron se përformancën e procesorit nuk e përcakton vetëm numri i frekuencës (GHz) dhe NUK është element absolut apo indikatorë mbi bazën e të cilit mund të krahasohen dhe vlerësohen dy procesorë. (Këtu duhet ta plotësojmë dhe ta Ri-konfirmojmë

gjithashtu se CPU-ja e pajisjes së ofertuar nga ne e ka numri i Cora-ve të njëjtë me atë që kërkohet ne Aneksin 1 të DT).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit, specifikacionit teknik të bashkangjitur si fakt 1 në këtë ekspertizë dhe broshurës të OE ankues, ku është i paraqitur produkti me të cilin ky OE ka aplikuar për grupin 1, konkretisht Tablet – Brand name. OE ankues ka ofertuar me produktin "muPAD L10 tabletë" i prodhuesit Koreano Jugor "FORYOU DIGITAL CO" LTD. http://ëëë.foryoudigital.com/22/?idx=254 , që është firmë koreano jugore me fabrikë për prodhim në Kinë. Paneli Shqyrtues sqaron se ekspertit konfirmon mgjashëm si në ekspertizën paraprake dhe në njoftimin mbi vendimin e AK-së pas rivlerësimit, që produkti i ofertuar nga OE ankues përmban procesor me 8 bërthama (core) njëjtë si është kërkesa nga AK, është model "Spreadtrum SC9863A Octa Core (8-bërthamësh)" pra janë 8 procesorë në një qark të vetëm", i familjes *ARM* Cortex *A-55* i cili i ka të ndara 4 bërthama me frekuencë 1.6GHz dhe 4 bërthama me frekuencë 1.2GHz, që sa i përket frekuencës së procesorit nuk e plotëson kërkesën obligative në DT ku kërkohen minimum 4 bërthama 2.3GHz and 4 bërthama 1.7GHz. Sa i përket pretendimit ankimor është e vërtetë që në përformancen e përgjithshme të procesorit sado që është faktor me rendësi nuk është vendimtar vlera e frekuencës e shprehur në GHz apo MHz, përpos kësaj faktor me rendësi tek performansa e procesorit janë edhe ndër të tjera: Bus-i i përparmë, cashe memoria, shpejtësia e clockut që tregon numrin e operacioneve te cilat mund ti ekzekutoj procesori brenda sekondës-ciklit (e sqaruar në mënyrë te detajuar dhe shkollore nga ana e AK-së në përgjigjen e tyre në kërkesën për rishqyrtim të datës 05.11.2020), sa me e lartë të jetë shpejtësia e clockut aq me shumë veprime mund ti ekzekutoj procesori brenda ciklit, kjo në fakt është edhe rasti me produktin e OE ankues, por është e rëndësishme të kuptohet se shpejtësia e clock-ut e një procesori nuk është faktori i vetëm që përcakton performancën e tij. Për shkak të ndryshimeve në arkitekturën e çipave (familjet e procesorëve) dhe zhvillimit të hovshëm teknologjik të këtyre komponentëve, një procesor mund të jetë në gjendje të kryejë më shumë veprime sesa një tjetër për një cikël, madje edhe nëse procesori i parë ka një shpejtësi më të vogël (frekuencë) të clock-ut sesa i dyti, ky është rasti i produktit të ofruar nga OE ankues, produkt i cili ka procesor te familjes me të re se sa ai i produktit të OE te propozuar për tu shpërblyer me kontratë, është e vërtetë se është më pak i shitur se procesori ARM Cortex A-53, por kjo është e kuptueshme sepse është zhvilluar dhe paraqitur në treg disa vite me vonë. https://ëëë.techëalla.com/articles/hoë-is-the-cpu-speed-measured. Pra procesori i produktit të OE ankues është pasardhës me i avancuar i procesorit të produktit me të cilin kanë ofertuar GOE i propozuar për tu shpërblyer me kontratë. Busi i përparmë (front side bus) dhe cashe kanë gjithashtu rol shumë te rëndësishëm në përformansën e procesorit. Procesori dhe front side bus punojnë së bashku, kështu që ata do të jepnin përformansën ideale nëse do të funksiononin me të njëjtën shpejtësi në mënyrë që njëri të mos mund të ngadalësojë tjetrin. Cache-memoria gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në përformansën e procesorit, sa më e madhe të jetë memoria, aq më e mirë është performansa e procesorit. Me analizimin e procesorit të

produktit të ofruar nga OE ankues vërehet që këto përformansa janë mjaft të mira edhe pse shpejtësia e bërthamave është më e vogël se sa ajo e kërkuar në specifikacionin minimal teknik nga ana e AK-së dhe përpos kësaj shpejtësie në përgjithësi ky produkt i plotëson kërkesat minimale.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik konsideron që produkti i ofertuar nga OE ankues sa i përket frekuencës së procesorit nuk është në përputhje me kërkesat minimale teknike të cekura në dosje të tenderit, por sa i përket përformansës së përgjithshme dhe komponentëve tjera është mjaft i mirë dhe nuk ka dyshim që nuk do ta kryente pa problem qëllimin dhe detyrat për të cilat do të ngarkohet nga përdoruesit e fundit, e këtu ka rendësi edhe çmimi goxha më i ulët i këtij produkti në krahasim me produktin e ofertuar nga GOE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Më tej, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti i cili e ka trajtuar këtë lëndë, në ekspertizën paraprake ka dhënë sqarime duke krahasur procesorin e ofertuar nga OE ankues dhe OE i rekomanduar, ku procesori i ofertuar nga OE ankues është Cortex-A55 (ARM v8.2-A) ndërsa procesori i OE të rekomanduar për kontratë është Cortex-A53 (ARM v8.0-A). Sipas informatave të ARM
kups://community.arnt.cont/developer/ip-products/processors/b/processors-ip-bloz/posulann-cortex-a55-efficientperformance-from-edge-to-clondj,
procesori Cortex-A55 është gjeneratë pasardhëse e procesorit ARM Cortex-A53, i krijuar për të përmirësuar performancën dhe efikasitetin e energjisë. Gjithmonë sipas informatave të prodhuesit ARM, arkitektura Cortex A55 është për 15% më efikas në energji dhe 18% rritje të përformancës në krahasim me A53".

Në lidhje me pretendimin tjetër, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit, specifikacionit teknik, ofertave, broshurave, hulumtimit dhe krahasimit në internet, sqaron se duke marrë për bazë arkitekturën e procesorëve te këtyre produkteve, sipas sqarimit të dhënë nga vetë prodhuesi arkitektura e Cortex A55 ka avancime në performancë dhe efikasitetin në raport me arkitekturën e Cortex A53, familjes të së cilit i takon procesori i cili ndodhet në produktin e ofertuar nga OE i propozuar për kontratë, shih vegzat ne vijim te nxjerra nga ëeb faqja e prodhuesit:
https://community.arm.com/developer/ip-products/processors/b/processors-ip blog/posts/arm-cortex-a55-efficient-performance-from-edge-to-cloud dhe https:// developer. arm.com/ip-products/processors/cortex-a/cortex-a55, rrjedhimisht në kuptimin e përmbushjes së qëllimeve të aktivitetit të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik konsideron se procesori i produktit të ofertuar nga OE ankues përmbush funksionet dhe arrin performancën e kërkuar. Pra, pretendimi ankimor është i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se AK si kriter të saj për dhënien e kontratës ka përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët ashtu siç e parasheh neni 52 të LPP. Por në praktikë është e kundërta me veprimet e AK (MASHT), e eliminon ofertën e përgjegjshme me çmim më të ulët (823.500 € të OE BOTEK sh.p.k. apo 165€/copë) dhe propozon për kontratë një ofertë tej mase me të lartë 1.139.400 €, apo 227€/copë, rrjedhimisht 38% me të lartë). Për Informacionin tuaj; Çmimet standarde (me pakicë) gjithandej nëpër Evropë janë më të ulëta, sikurse: https://gjirafa50. com/celulare-tablete-dhe-pajisje-smart/tablete/me-google-android/tablet-lenovo-m10-plus,-4gb-64gb,-hiri/#rel=2 https://ëëë.idealo. de/preisvergleich/ OffersOfProduct/ 7041006_ -tab-m10-plus-za5t0302-lenovo.html (Gjermani – DE, çmimet mesatare të këtij Tableti Inkl. VAT dhe Transporti në shtëpi kudo ne DE). https://ëëë.coolshop.co.uk/product/lenovo -m10-fhd-plus-2nd-gen-tb-x606ftablet/234S9V/?utm_medium=affiliate&utm_source=salestring&utm_campaign=The+Affiliate+Gateëay%E2%80%8B_(Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakice për cope incl. VAT dhe Transporti deri ne shtëpi kudo ne UK).

https://ëëë.lenovo.com/gb/en/tablets/android-tablets/lenovo-tab-series/Lenovo-TB-X606Smart-Tab/p/ZZITZTMST0X (Britaninë e Madhe - UK, çmimi me pakice për cope incl. VAT dhe Transporti ne shtëpi ne UK).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të Dosjes së tenderit, dhe ofertave të dorëzuara nga ana e OE ankues dhe atyre të propozuar për shpërblim me kontratë e konfirmoj që Oferta e OE ankues në total dhe për copë është me e lirë se ajo e GOE te propozuar (te cilët kanë ofertuar me produktin Lenovo Tab M10 FHD plus), por këtu kemi te bëjmë me dy produkte të ndryshme te prodhuesve të ndryshëm të përberë nga komponentë të ndryshme por me përformanca të përafërta, gjithashtu edhe çmimet në linçet e paraqitura nga OE ankues në ankesë dhe se janë me të lira (çmimi pakicë fillon nga 174.37 me TVSH të përfshirë, 188.00 dhe 205.00 euro) se çmimi që është ofruar nga OE i propozuar, por prapë se prapë për të bëre krahasim të mirëfilltë duhet krahasimi të behët në kushte të njëjta siç janë sasia, garancioni 2 vjeçar, liferimi e që këto kushte nuk janë në ketë rast. Tek çmimi që është me i lartë duhet të ketë ndikuar jo vetëm se brendi "Lenovo" është brend me i njohur dhe më i përhapur se sa brendi i produktit te ofertuar nga OE ankues, por edhe kërkesa obligative e cekur në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë nga ana e AK-së ku kërkohet garancion 2 vite si dhe liferimi të bëhet brenda 45 ditëve pas porosisë.

Kriter për dhënie të kontratës është "tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët", kurse oferta e OE të propozuar është më e lartë nga të gjitha ofertat tjera por prapë se prapë është brenda buxhetit të paraparë nga AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit publik dhe nëse do të pranoheshin specifikat teknike të produktit të diskutuara në pretendimet 1 dhe 2 atëherë do të duhej të propozohej për kontratë oferta e OE ankues. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se AK nuk ka vepruar tërësisht në përputhje me vendimin Panelit Shqyrtues PSH.nr.673/20 të datës 22.10.2020 dhe udhëzimet e këtij vendimi nuk janë aplikuar plotësisht nga AK. Rrjedhimisht, për shkak të mos zbatimit në tërësi të vendimit paraprak nga AK ka rezultuar se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nuk ka pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të zbatoj vendimet e Panelit Shqyrtues në përpikëri dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron autoritetit kontraktues që qëllimi i ligjit është që fondet publike duhet të përdorën në mënyrë më ekonomike, si dhe AK duhet të ketë parasysh edhe nenin 6 me qëllim të arritjes së ekonomicitetit dhe efikasitetit. Përderisa, tenderi i OE ankues është me çmim dukshëm më të lirë, atëherë AK duhet të zbatoj në përpikëri nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Në të kundërtën, AK e obligon Panelin Shqyrtues që të merr masa konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria e Arsimit"

1x1 OE "Botek"SH.P.K -Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.